



**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°26/2022

Hagë, 07/07/2022

**Përditësim**

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Të dielën më 3 korrik, në pajtim me një urdhër të panelit të Gjykatës së Apelit, Zyra Administrative e DHSK-së organizoi një vizitë si i paraburgosur të Hysni Gucatit në Kosovë për arsye humanitare bindëse, për të takuar familjen e ngushtë. Z. Gucati ishte i paraburgosur dhe nën ruajtjen e gjykatës gjatë vizitës. Në realizimin e kësaj vizite, personeli i Dhomave të Specializuara u ndihmua nga EULEX-i dhe Policia e Kosovës. Z. Gucati u kthye përsëri në objektin e paraburgimit të DHSK-së në mbrëmjen e 3 korrikut. Vendimi i panelit të Gjykatës së Apelit gjendet në faqen e Dhomave të Specializuara në internet.

Këtë javë pati edhe disa zhvillime të tjera lidhur me procedurën e apelit në çështjen *Gucati dhe Haradinaj*.

Më 1 korrik, paneli i Gjykatës së Apelit urdhëroi Nasim Haradinajn që brenda një jave nga marrja e urdhrit të panelit, të dorëzojë edhe një herë njoftimin për apel në tërësi. Arsyet për këtë përfshinin mospërmbyshjen e kriterëve për dorëzimin e parashtrimeve. Sipas rregullave përkatëse, njoftimi për apel duhet të përcaktojë qartë gabimet e pretenduara faktike, ligjore, ose në përcaktimin e dënimit, si edhe pjesët e Aktgjykimit ku pretendohet se gjenden ato gabime.

Paneli i Gjykatës së Apelit u shpreh gjithashtu se z. Gucati dhe z. Haradinaj nuk mund të përfshinin në mënyrë të përgjithshme argumentet e njëri-tjetrit në parashtrimet e tyre.

Po kështu, paneli anuloi një nga pikat e apelit të paraqitura në njoftimin për apel të z. Gucati dhe e urdhëroi atë që ta dorëzojë përsëri njoftimin brenda të njëjtit afat, nëse dëshiron që përmbajtja e asaj pike të vazhdojë të jetë pjesë e njoftimit.

1





**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°26/2022

Hagë, 07/07/2022

Të martën më 5 korrik u mbajt konferenca para apelit, që u drejtua nga gjykatësja Mishelë Pikar. Gjatë konferencës, z. Gucati dhe z. Haradinaj patën mundësi të ngrinin çështje lidhur me paraburgimin, përfshirë edhe lidhur me gjendjen shëndetësore. Një pjesë e seancës ishte në seancë private.

Lidhur me hapat e mëtejshëm në çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, afati për dorëzimin e dosjeve të tyre të apelit, me shtjellime të argumenteve për secilën pikë të apelit, është data 19 gusht 2022.

Në çështjen gjyqësore kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, konferenca e ardhshme për ecurinë e çështjes do të zhvillohet më 13 korrik 2022 në orën 13:30.

Më 30 qershor 2022, Kryetarja e DHSK-së caktoi një Panel të Gjykatës Supreme për të vendosur mbi një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga Mbrojtja e Veselit, e cila kundërshton një vendim të panelit të Apelit lidhur me paraburgimin e z. Veseli.

“Mbrojtja e ligjshmërisë” është një mjet juridik i jashtëzakonshëm që mund të kërkohej nga Mbrojtja në pajtim me Rregulloren e Procedurës dhe të Provave të DHSK-së për të kundërshtuar vendimet me të cilat urdhërohet paraburgimi ose vazhdimi i paraburgimit. Një kërkesë e tillë duhet të pretendojë shkelje të së drejtës penale ose shkelje thelbësore procedurale.

Anëtarët e panelit të Gjykatës Supreme janë gjykatësit Ekaterina Trendafilova, Kristinë van den Vajngart, dhe Mihael Bolander. Sipas Rregullores së Procedurës dhe të Provave, çdo Panel i Gjykatës Supreme kryesohet nga Kryetarja e Dhomave të Specializuara.

Më 6 korrik 2022, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, e përbërë nga gjykatësit Vidar Stensland, Rumen Nenkov dhe Romina Inkuti, nxorën vendimin mbi

2





**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°26/2022

Hagë, 07/07/2022

kërkesën referuese të Pjetër Shalës që pretendonte shkelje të të drejtave themelore të tij dhe paraqiste kundërshtime ndaj juridiksionit të DHSK-së. Paneli konstatoi se kërkesa referuese ishte e parakohshme dhe, rrjedhimisht, e shpalli atë të papranueshme në pajtim me nenin 113(7) të Kushtetutës, nenin 49(3) të Ligjit dhe rregullën 14(f) të Rregullores së Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

Ndër lajme të tjera: ditën e hënë, Kryetarja e DHSK-së Ekaterina Trendafilova mbajti një takim në internet me shoqërinë civile dhe gazetarë nga Kosova, në kuadër të programit për komunikim dhe ndërgjegjësim. Gjatë këtij takimi, që zgjati dy orë, Kryetarja i informoi pjesëmarrësit në lidhje me ecurinë e proceseve gjyqësore dhe iu përgjigj pyetjeve.

**Pyetje nga gazetarët**

Nuk pati pyetje.

